



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.75/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi - kryesues, Violeta Husaj Rugova, dhe Hajriz Hoti - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, të parashtruar kundër subjektit politik Lista Serbe, me seli në Komuna Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më 01.10.2025, merr këtë :

V E N D I M

I. PRANOHET E BAZUAR ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Komuna Prishtinë, ZL.Anr.75/2025 datë 29.09.2025.

II. Subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025 që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 800 (tetëqind) Euro.

III. DETYROHET Subjekti politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

IV. URDHËROHET Subjekti politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, që nga momenti i marrjes së këtij vendimi ti largojë posterat e vendosur në objekte banesore kolektive në rrugën "Princi Milosh", në Mitrovicën e Veriut, përndryshe mosbindja ndaj kësaj urdhërese paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënime shtesë nga PZAP-i.

A r s y e t i m

Me datë 29.09.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën e identifikuar me numër ZL.Anr.75/2025, nga subjekti politik LVV me të cilën pretendon se më 28.09.2025 aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje, kanë vërejtur që në rrugën "Princi Milosh", në Mitrovicën e Veriut, është evidentuar vendosja e posterëve zgjedhorë të subjektit politik Lista Serbe në objekte banesore kolektive. Sipas parashtruesit të ankesës ky veprim është në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 2.6 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, e cila

ndalon vendosjen e materialeve zgjedhore në ndërtesa apo objekte banimi përveçse me pëlqimin paraprak të banorëve dhe kur janë të kontraktuara.

Parashtuesi i ankesës thekson se vendosja e tillë e materialeve zgjedhore, pa pëlqimin paraprak të banorëve dhe pa kontraktim të rregullt, përbën shkelje të drejtpërdrejtë të dispozitave të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024 për fushatën zgjedhore, dhe ky veprim jo vetëm që cenon barazinë ndërmjet subjekteve politike në procesin zgjedhor, por krijon gjithashtu një praktikë të papranueshme të uzurpimit të hapësirave të përbashkëta banesore, duke i ekspozuar qytetarët ndaj propagandës së pavullnetshme në mjediset ku ata jetojnë dhe ku duhet të ndihen të mbrojtur nga presioni politik. Sipas parashtuesit të ankesës kjo lloj praktike bie ndesh me parimin e barazisë së garës zgjedhore, me të drejtën për zgjedhje të lira e të ndershme dhe me standardet e demokracisë, duke i vendosur disa subjekte në një pozitë më të privilegjuar përballë të tjerëve përmes shfrytëzimit të hapësirave të palejuara.

I njëjti kërkon nga PZAP-i që të konstatojë shkeljen e bërë nga Lista Serbe dhe të ndërmarrë masat e parapara ligjore, duke përfshirë urdhrin për largimin e menjëhershëm të materialeve të vendosura në mënyrë të kundërligjshme dhe shqiptimin e sanksioneve administrative të përcaktuara nga ligji dhe rregulloret zgjedhore. Si dëshmi ka bashkangjitur një fotografi.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik Lista Serbe thekson se në lidhje me vendosjen e materialit promovues të Listës Serbe në vendin e banimit kolektiv në Mitrovicë Veriut në rrugën "Knjaza Miloša", pa dëshmi se është marrë pëlqimi i banorëve të ndërtesës së lartpërmendur për vendosjen e materialit. Të njëjtit në përgjigjen në ankesë theksojnë se i hedhim poshtë këto pretendime sepse nuk janë të vërteta, pasi që Lista Serbe ka pëlqimin e banorëve të objektit të lartpërmendur (të cilin e bashkëngjisim si shtojcë) dhe siç shihet kuartë, ata janë pajtuar që Lista Serbe të vendosë material promovues në hyrjen e tyre në lidhje me fushatën zgjedhore për zgjedhjet lokale që do të mbahen më 12 Tetor, gjë që është në përputhje me Rregullën Zgjedhore 7/2024, neni 7 paragrafi 2.6.

Gjithashtu, në përgjigje në ankesë theksojnë se pas një shqyrtimi të kujdesshëm të ankesës Anr.75/2025, të cilën e ka parashtuar Lëvizja Vetëvendosje, në anën e dytë poshtë majtas shkruan si datë 20.09.2025. Kjo datë shënon shkeljen e Rregullës Zgjedhore nr. 1/2025, konkretisht neni 9, paragrafi 5, i cili parasheh që afati për paraqitjen e ankesës, pas shkeljes së kodit të sjelljes së subjekteve politike, mbështetësve dhe kandidatëve të tyre, është 48 orë, ndërsa ankesa në fjalë është dorëzuar 9 ditë më vonë. Të njëjtit propozojnë që PZAP-i ta pranojë këtë përgjigje në ankesë si të bazuar dhe që ta hedhë poshtë ankesën e parashtuar nga Lëvizja Vetëvendosje si të pabazuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa-PZAP, pasi shqyrtimit të ankesës, dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

-Ankesa është e bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, dhe përgjigjes në ankesë të parashtuar nga subjekti politik Lista Serbe, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LVV, janë të qëndrueshme dhe të bazuara, dhe si të tilla i aprovoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje nga ana e subjektit politik Lista Serbe, ngase e njëjta ka vendosur posterët në objekte banesore kolektive, përkatësisht në rrugën "Princi Milosh" në Mitrovicën e Veriut, me të cilat iu bënë thirrje qytetarëve për votimin e subjektit politik, Lista Serbe me

numër 170 për procesin zgjedhor për zgjedhjet lokale që do të mbahet me datë 12 tetor 2025, ku me këto veprime ka shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin nen ndër të tjera thuhet se *“Veprimet e ndaluara të Subjekteve Politike...Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim : natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor. Po ashtu, Subjekti Politik, Lista Serbe, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore, prandaj vendosja e posterëve-njoftimeve të subjektit të tyre politik për fushatë zgjedhore në objekte publike gjegjësisht në objekte banesore kolektive në Mitrovicën e Veriut, përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor, dhe të njëjta shkelje janë sanksionuar me nenin 34 par.1 nën par.1.2 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Subjekti Politik, Lista Serbe në përgjigje në ankesë ka kundërshtuar ankesën e parashtruesit të ankesës duke theksuar se posteret janë vendosur me pëlqim të banorëve të objektit banesor të cilët kanë dhënë pëlqimin paraprak për vendosjen e tyre.

Për Panelin këto pretendime janë të pa bazuar, për faktin se posterët janë vendosur në hapësirën e jashtme të objektit të banimit kolektiv, dhe se për këtë raste duhet leje e veçantë, përkatësisht, pëlqim nga Drejtoria përkatëse të lëshuar nga Komuna e Mitrovicës së Veriut. Kurse në rastet kur objektet janë private, atëherë duhet të sigurohet pëlqimi me shkrim nga pronari-shfrytëzuesi i objektit.

Sa i përket pretendimit në përgjigje në ankesë, se ankesa është dorëzuar jashtë afatit ligjor, dhe në anën e dytë të ankesës shkruan si datë 20.09.2025, ky pretendim është i pa bazuar, pasi që në ankesën e dorëzuar nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, ndër të tjera thuhet se *“Më 28.09.2025 aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosjes, kanë vërejtur që në rrugën “Princi Milosh”, në Mitrovicën e Veriut, është evidentuar vendosja e posterëve zgjedhor të subjektit politik Lista Serbe...”*, ndërsa ankesa në PZAP, është dorëzuar me datë 29.09.2025, që i bjen se është dorëzuar brenda afatit ligjor bazuar në nenin 9.5.5 të Rregullores nr.01//2025 për procedurat e parashtrimit e parashtrimit dhe vendosjes së ankesave.

Paneli po ashtu vlerësoi edhe pretendimet tjera nga përgjigja në ankesë, mirëpo të njëjtat i vlerësoi si të pa bazuara, për faktin se të njëjtat nuk janë provuar me asnjë provë të vetme.

Prandaj, duke u mbështetur në nenin 117.3 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës në të cilin nen në mënyrë thuhet se *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla të palës ankuese janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike,

kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi si të bazuar.

Paneli vlerëson se në rastin konkret Lista Serbe, urdhërohet që nga momenti i marrjes së këtij vendimi të largojë posterat e vendosur në objekte banesore kolektive, përkatësisht në rrugën "Princi Milosh", ndërsa dështimi për t'iu bindur kësaj urdhëresë të PZAP-it, brenda periudhës së përmendur në vendim, paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënime shtesë nga PZAP-i.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1, dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, dhe paragrafi 2, të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.75/2025 më datën 01.10.2025

Kryesues i Panelit,

Bujar Muzaqi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.